

**MEHMET PASHË DERALLA – LUFTËTAR I SHQUAR  
I PERIU DHËS SË RILINDJES KOMBËTARE  
Xhelal ZEJNELI**

**UDK: 323.1:329(497.115:=18)"1878"**

**Abstrakt**

Atje ku është etnia dhe shumësia shqiptare, atje është Shqipëria – lajtmotiv i rilindësve. Një ndër veprimtarët më të spikatur të Lëvizjes Kombëtare në trevat verilindore është edhe Mehmet Deralla. Emri i këtij personaliteti figuron edhe si Mehmet Pashë Deralla, apo Mehmet Pashë Tetova. Veprimtaria e tij është zhvilluar në dy dimensione: në dimensionin ushtarak dhe në atë politik.

I lindur në vitin 1843, pra në vitin e Kryengritjes së Dervish Carrës, në fshatin Gradec të Pollogut, ai do të vazhdojë traditën patriotike të familjes së tij. Ky personalitet prominent i popullit shqiptar, ishte njeri me vetëdije të lartë kombëtare. Mësimet e para dhe arsimimin fillor i mori në vendlindje. Duke qenë se babai i tij – Hasan Deralla ishte njeri i arsimuar dhe atdhetar i shquar, Mehmet Deralla nuk reshti së shkolluari. Vazhdoi shkollimin në Manastir, qendër kjo që pak më vonë do të shndërrohet edhe në qytet historik. Në qytetin e shkronjave të shqipes, Mehmet Deralla do të kryejë gjimnazin. Duke qenë nxënës i dalluar dhe i zgjuar, ai do të regjistrohet në Akademinë Ushtarake për oficer në Stamboll. Suksesi në shkollimin e lartë ishte motiv të vazhdonte studimet në Akademinë e Shtatmadhorisë, në kryeqytetin perandorak. Në moshën 35-vjeçare merr gradën e gjeneralit.

**Fjalë kyçe:** Lëvizja kombëtare, Mehmet Pashë Deralla, vetëdija kombëtare, akademia ushtarake.

I dalluar në mësim dhe i disiplinuar si ushtarak, autoritetet perandorake e caktuan në funksione të larta ushtarake si dhe në detyra xhandarmërie. I formuar politikisht dhe i ngritur ushtarakisht, Mehmet Deralla shërbeu si qeveritar, por edhe si komandues, që nga Iraku deri në vilajetet e Kosovës dhe të Manastirit. Fillimisht, nga autoritetet perandorake u emërua gjeneral i xhandarmërisë. Në vijim ushtroi funksione të larta ushtarake në Bagdad, në Alepo të Sirisë dhe në Selanik. Pas shërbimit në Selanik, ai u transferua në Shkup, nga ku i komandoi njësitë ushtarake perandorake të zonës së Prizrenit.

Niveli i lartë arsimor dhe vetëdija e lartë kombëtare, bënë që Mehmet Deralla kurrë të mos e harronte çështjen kombëtare shqiptare. Familja nga e cila vinte ai, ishte një vatër e dijes dhe e atdhedashurisë. Nuk duhet harruar se fshati Gradec ku lindi dhe u rrit Mehmet Deralla, është pak kilometra larg fshatit Pallçisht të Tetovës, vendlindjes së një figure tjetër të madhe të historisë së popullit shqiptar – Dervish Carrës, prijësit të kryengritjes kundërosmane, që në histori njihet si Kryengritja e Dervish Carrës, e vitit 1843-1844.

Në çastet kur e kërkonte momenti historik, Mehmet Deralla braktisi privilegjet që i gëzonte në qarqet ushtarake dhe politike perandorake. Me një fjalë, ai e ndërpreu karrierën zyrtare dhe iu përkushtua Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Koha kur u krijua personaliteti i tij ushtarak dhe politik, i përket periudhës së Rilindjes Kombëtare.

Asokohe, elita intelektuale shqiptare vepronte në qendra të caktuara, si: në Stamboll, në Bukuresht, në Sofje, në Selanik, në Kajro, në Aleksandri dhe gjetkë. Arbëreshët ndërkaq, qysh në vitin 1836, me në krye Jeronim de Radën, kishin filluar veprimtarinë e tyre letrare-artistike, folklorike, publicistike, gjuhësore etj.

Periudha e Rilindjes Kombëtare fillon nga mesi i shekullit XIX me atdhetarin e shquar Naum Veqilharxhin. Ideologët dhe patriotët

nacionalistë shqiptarë si Sami Frashëri, Pashko Vasa, Hasan Tahsini, Zef Jubani, Jani Vreto, Ismail Qemali, Koto Hoxhi, Konstandin Kristoforidhi, Thimi Mitko, Spiro Dine e të tjerë, vepruan pa reshtur për ta rilindur kombin dhe për ta nxjerrë atë nga errësira mesjetare. Në mesin e tyre, për ta ripërtërirë kujtesën e fjetur historike, do të tretet si qiri edhe apostulli i shqiptarizmit – Naimi i madh. Jehona e rilindësve tanë u përhap si valë deti në të gjitha trojet etnike arbërore, përfshi edhe ata që ishin vendosur nëpër kolonitë dhe në ngulimet shqiptare.

I ndikuar nga ideologjia e rilindësve, Mehmet Deralla e intensifikoi veprimtarinë e vet në funksion të një kauze, historikisht të drejtë. Atdheu, mbi të gjitha. Pasi i dha fund karrierës së tij në ushtrinë osmane dhe pasi e ndërpreu lojalitetin ndaj Portës së Lartë, Mehmet Deralla e shfrytëzoi ndikimin e vet për të nxitur revoltë kundërosmane në Kosovë. Në vitin historik të 1878-ës, Mehmet Derallën e gjejmë të marrë pjesë në Kuvendin e Lidhjes së Prizrenit, në krah të Iljaz pashë Dibrës, të Abdyl Frashërit, të Haxhi Zekës dhe të shumë atdhetarëve të tjerë. Duke iu bashkuar forcave ushtarake të Lidhjes së Prizrenit, Mehmet Deralla u caktua këshilltar i Sulejman Vokshit, i cili ishte ministër i Mbrojtjes në Qeverinë e Përkohshme të Lidhjes. Autoritetet osmane u përpoqën ta arrestojnë Mehmet Derallën, por nuk ia dolën.

Rilindësit tanë i hetuan shpejt rreziqet që u sillte shqiptarëve Traktati i Shën Stefanit (1877-78) dhe Kongresi i Berlinit (1878). Prandaj, që nga kuvendi historik i Lidhjes së Prizrenit, Shqipëria pandalshëm shkonte drejt pavarësisë nga Porta e Lartë. Aq më tepër, kur tre vendet e gadishullit – Serbia, Mali i Zi dhe Rumania tanimë u bënë shtete të pavarura. Në rrugën e tyre ecte me të shpejtë edhe Bullgaria. Amputimi trojeve shqiptare, tanimë kishte filluar.

Veprimtaria atdhetare e Mehmet Derallës nuk ndalet në asnjë çast. Më 1899, ai merr pjesë në Kuvendin e Pejës, përkatësisht në kuvendin e Lidhjes Shqiptare të Pejës, të mbajtur më 23-29 janar 1899-1900. Kjo lidhje ishte një organizatë politike-ushtarake mbarëshqiptare, e cila

ndoqi rrugën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe e cila luftoi për çlirimin e vendit nga sundimi osman dhe për bashkimin e tij kombëtar. Kjo organizatë e quajtur edhe “Besa-Besë”, kishte Komitetin drejtues, në krye të të cilit u vu Haxhi Zeka. Në këtë kuvend morën pjesë mbi 450 vetë, të ardhur nga vise të ndryshme të Shqipërisë dhe kryesisht nga qendrat e vilajetit të Kosovës. Krahu tyre qëndronte edhe Mehmet Deralla.

Autoritetet osmane e arrestuan Mehmet Derallën dhe e internuan në shkretëtirat e Irakut. Pas amnistisë nga xhonturqit, ai u rikthye në Kosovë. Me dobësimin permanent të Perandorisë, autoritetet osmane përsëri i ofruan Mehmet Derallës post në ushtrinë perandorake, por ai refuzoi, duke u thënë se ka kohë që i takonte një kauze tjetër – kauzës kombëtare shqiptare.

Preokupim themelor i elitës politike dhe intelektuale të kombit, që nga Kongresi i Berlinit e këndej ishte: të parandalohet copëtimi i trojeve etnike shqiptare; të ruhet tërësia territoriale e Shqipërisë; të çohet vendi drejt pavarësisë.

Duke qenë ushtarak, njëherazi dhe atdhetar i shquar, Mehmet Deralla ishte një ndër prijësit kryesorë të kryengritjeve të mëdha kundërosmane të viteve 1910, 1911 dhe 1912. Në verë të vitit 1912, kryengritjet kundërosmane arritën kulmin, gjë që rezultoi me marrjen e Shkupit – qendrës së vilajetit të Kosovës.

Si një figurë e rëndësishme e kryengritjeve kundërosmane dhe e qëndrësës ndaj forcave pushtuese serbo-malazeze, në vjeshtën e tretë të vitit 1912, Mehmet Deralla merr pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe është një nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë. Sikundër 63 delegatët e tjerë të të gjitha trojeve të Shqipërisë, Mehmet Deralla do të jetë pranë Plakut të Vlorës dhe Babait të Kombit – Ismail Qemalit.

Në atë kuvend historik u themelua edhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e përbërë prej personaliteteve, si: Ismail Qemali - kryeministër dhe ministër i Jashtëm, Dom Nikoll Kaçorri - zëvendëskryeministër, Myfit bej Libohova - ministër i Brendshëm, Gjeneral Mehmet Pashë Deralla - ministër i Luftës, Abdi bej Toptani - ministër i Financave, Dr. Petro Poga - ministër i Drejtësisë dhe i Sistemit Gjyqësor, Dr. Luigj Gurakuqi - ministër i Arsimit, Mit'hat Bej Frashëri - ministër i Punëve Publike, Pandeli Cale - ministër i Agrikulturës, Lef Nosi - ministër i Post-Telegrafit.

Për ministër të Luftës e ka propozuar Isa Boletini. Prej 58 vetëve që kanë marrë pjesë në votimin e anëtarëve të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, Mehmet Deralla me 42 votat e marra, është i treti për nga numri i votave, pas Myfit Libohovës me 54 vota dhe Luigj Gurakuqit me 52 vota. Kjo dëshmon për autoritetin që ka gëzuar.

Si ministër i parë i Luftës i shtetit shqiptar, gjeneral Mehmet Deralla kontribuoi për themelimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, gjë që u realizua më 4 dhjetor 1912. Pas themelimit të ushtrisë së shtetit, ai u angazhua edhe për organizimin e saj.

Është kohë e luftërave ballkanike (1912-1913), e Luftës së Parë Botërore, e vitit të mbrapshtë, siç do ta quajë në mënyrë metaforike Ismail Kadareja. Fqinjët e shqiptarëve, serbët, malazezët, bullgarët dhe grekët, të mbështetur nga Rusia cariste dhe jo vetëm prej saj, bëjnë si hiena për t'i grabitur trojet shqiptare. Pas Kongresit të Berlinit, mbi shqiptarët pasuan gërshërët e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-13). Mehmet Deralla është, jo vetëm bashkëkohës i këtyre ngjarjeve dramatike për kombin, por edhe strateg dhe luftëtar syptrembur, në krye të betejave për mbrojtjen e vendit. Në vitin 1913, Mehmet Deralla është një ndër ushtarakët dhe protagonistët kryesorë edhe në kryengritjen e shtatorit të vitit 1913, kundër pushtuesve serbë dhe malazezë, të cilët synonin ta pushtonin veriun e Shqipërisë. Nën komandën e tij, kryengritësit shqiptarë arritën t'i

sprapsin forcat serbe në zonën midis Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Ishte kjo kryengritja e parë, me përmasa të gjera, që popullsia e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare të aneksuara nga Serbia dhe Mali i Zi, ndërmori për t'u çliruar nga zgjedha serbo-malazeze dhe për t'u bashkuar me shtetin e pavarur shqiptar. Kjo kryengritje kundërserbe u ndërmor për shkak të copëtimit të Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve, si dhe politikës së dhunës, të shfarosjes dhe të shpërnguljes së popullsisë shqiptare, që Serbia dhe Mali i Zi i zbatuan në territoret e aneksuara të Kosovës dhe në viset lindore dhe veriore të Shqipërisë. Mehmet Deralla qëndronte krah organizatorëve të kryengritjes - Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Isa Boletinit, Elez Isufit etj.

## **Përfundim**

Në vitin 1916 Mehmet Deralla u burgos nga Serbia. Një vit e gjysmë qëndroi në kazamatet e Beogradit dhe të Podgoricës, ku sipas disa studiuesve, më 1918 gjeti vdekjen me helmim. Por, ka studiues të tjerë që thonë se ky strateg i luftës ka ndërruar jetë në Tetovë dhe është varrosur në Teqenë Harabati Baba të këtij qyteti. Varri i tij në këtë teqe, nuk dihet. Ka pasur studiues që kanë thënë se Mehmet Deralla ka vdekur në Shkodër. Për vdekjen e tij duhet konsultuar edhe shkrimet biografike - të papublikuara - të të birit Gajur Derallës. Mehmet Deralla, ky personalitet i shquar dhe historik i kombit, meriton vëmendjen e historianëve, të shtetit shqiptar dhe të shoqërisë shqiptare.